



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.994/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit,, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “E...” Sh.P.K me seli në Obiliq, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2560/19, të datës 26.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2560/19, i datës 26.07.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2560/19 të datës 27.07.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “E...” Sh.P.K me seli në Obiliq, si e bazuar Anullohet aktvendimi nr.01.3.2.2/10029 i datës 09.09.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Obligohet e paditura Doganës së Kosovës në Prishtinë, që paditësit “E...” Sh.P.K me seli në Obiliq, t’ia kthej shumë prej 1,625.70€ (një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë euro e shtatëdhjetë cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-40289 të datës 08.07.2019, të proceduar në Zyrën doganore Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës material, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës LKA. Me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës si e bazuar në ligj, Priset aktgjykimi A.nr.2560/19 i datës 26.07.2021 si i

pabazuar në ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pabazuar me ligj dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar ose ta kthej në rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/10029 i datës 09.09.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë “E...” Sh.P.K me seli në Obiliq, për rishqyrtimin e vendimit nr. R-40289 të datës 08.07.2019 të ZBD Prishtinë, me të cilin vendim i është kontestuar vlera e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim, se e pabazë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit “E...” Sh.P.K me seli në Obiliq, t’ia kthej shumë prej 1,625.70€ (një mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë euro e shtatëdhjetë cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes deklaratës Unike Doganore (DUD) me nr.R-40289 të datës 08.07.2019, të proceduar në Zyrën doganore Prishtinë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Me arsyetim se gjykata nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, vlerëson se me asnjë dëshmi nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e mallit e paguar me qellim importi në vendin tonë, në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konstaton se e paditura do të mund ta mbështet një konstatim të tillë, vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete dhe bindëse se paditësi për mallin lëndor të importuar i ka paguar eksportuesit të mallit – subjektit “P.I.C “Co nga Republika e Maqedonisë së Veriut, mbi çmimin e faturës neto të mallit me nr.19-380-00139 të datës 04.07.2019, ku vlera e mallit të faturuar nga eksportuesi është 23,520.00€, vlerë kjo edhe e paguar nda paditësi – importuesi i mallit përmes transferit bankar të datës 17.07.2019, ku përshkrimi i transaksionit është “pagesë për kakao nr.19-380-00139, apo në rast se e paditura do të kontestonte validitetin e dokumentacionin përcjellës të mallit të paraqitur nga paditësi, çka nuk ka ndodhur në këtë rast. Gjykata vlerëson se nuk përben shkak ligjor për rivlerësimin e mallit dhe caktimin e bazës së re doganore për paditësi, fakti që e paditura ka disponuar më të dhëna të disponueshme nga dosja e vlerës, respektivisht çmimet për mallin e ngjashëm në bursën “R...” të datës 25.12.2018, të cilat çmime dallojnë me çmimin e mallit lëndor të deklaruar nga paditësi, sepse ne dispozitën ligjore të nenit 31 paragrafi 1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të ngjashme në bursa ndërkombëtare, siç është rasti me bursën “R...”, por aty

përkundrazi shprehimisht përcaktohet se “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin e vërtet të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovës, i përshtatur sipas nevojës në përputhje me nenet 26 apo 37”. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që “Çmimi i vërtet i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë nga blerësi për shitësin në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshinë të gjitha pagesat e bëra ose që duhet bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palët të tretë për ta përmbush obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos behët patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të behët me anët të letrave të kredisë apo ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të behët drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë”.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërin dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmojë se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues, si dhe faturën përcjellëse të mallit lëndor, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia që t’i paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, por e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës faturën përcjellëse të mallit nr.19-380-00139 të datës 04.07.2019, transaksionin bankar, i cili është bërë pikërisht për numrin e faturës përcjellëse me të cilën është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, certifikatën e qarkullimit të mallit EUR 1, të cilat dokumentacione janë në tërësi të

harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, andaj gjykata konstaton se janë përmbushur kriteret ligjore për tu pranuar vlera e deklaruar sipas faturës së mallit të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore nr. R-40289 të datës 08.07.2019 të Zyrës Doganore Prishtinë. Prandaj, një veprim i tillë është në përputhje me dispozitat ligjore nga ligji nr.03/L-109. E paditura nuk ka bërë një vlerësim të drejtë me rastin e përcaktimit të vlerës së mallit doganor dhe në asnjë moment nuk ka nxjerrë konkluzion të drejtë në aspektin e gjendjes faktike , në raport me dokumentacionin e mallit të paraqitur me DUD-in nr. R-40289 të datës 08.07.2019 të ZBD Prishtinë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesat, e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.994./22, me datë 26.01.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami